Kleinnager / Rongeurs / Roditori
Albanisch / Albanais / Albanese

Fletë udhëzuese mbajtja e brejtësve të vegjël

(derrat Indie dhe lepujt e butë shiko fletën e veçantë udhëzuese)

Jeta mesatare: Vidhezat (hamsterët) mund të jetojnë 3 vite, minjtë vrapues (të quajtur gerbils ose minj kërcyes të shkretëtirës) deri 5 vite. Minjtë gjirizesh (nevojtoresh) janë shumë të ndjeshëm ndaj kancerit, prandaj kanë shpesh një jetë mesatare prej 1-2 vjet.

Shpenzimet

Kafsha	30-120 CHF	Varësisht nëse janë kastruar ose jo
Shpenzimet fillestare	600-1500 CHF	Ushqim, shpenzimet për veteriner, qëndrim në pansion për kafshë gjatë pushimeve ose përkujdesje te shtëpia
Shpenzimet vjetore	afër 300 CHF	Yem, veteriner masrafları, tatildeyken hayvan pansiyonu masrafı veya evde bakım masrafı
Të tjerat	Shpenzimet e jashtëzakonshme të veterinerit mund ta kalojnë shumë e çmimit të blerjes së kafshës, për shembull një operacion i tumori tek minjtë gjirizesh: 100-300 franga	

Mënyra e jetesës

Vidhezat (hamsterët), minjtë gjrizesh dhe minjtë janë natën aktiv, minjtë vrapues ditën aktiv. Para se të merret vendim për kafshë brejtëse duhet që pronarët e ardhshëm të informohen me themel tek specialistët dhe me literaturën e lëmisë.

Brejtësit e vegjël kanë nevojë për vend/hapësirë

Kafazet e zakonshëm janë shumë të vogla për mbajtje sipas nevojave të llojit. Minjtë vrapues dhe vidhezat (hamsterët) duhet të mbahen në një terren gjegjësisht në një kafaz me një hapësirë prej një gjysmë metër katror, minjtë gjirizesh së paku në një metër katror. Llojeve ngjitëse si vidhezat dhe minjtë gjirizesh duhet t´ju ofrohen shumë raste për ngjitje, llojeve të gërmuesve si minjtë e bardhë dhe minjve vrapues një mbushje (mbulim, më së paku 30 cm), në mënyrë
që të gërmojnë sistemet e tyre të ndërtimit.

Minjtë e gjirizesh dhe minjtë vrapues janë social

Shumica e brejtësve të vegjël të mbajtura si kafshë shtëpiake janë kafshë sociale dhe jetojnë në grupe në mënyrë paqësore, vetëm minjtë e bardhë bëjnë atëherë një përjashtim si vetjak. Njeriu nuk mundet të zëvendësoj një kafshë të llojit të njëjtë për kafshët sociale, prandaj duhet që edhe minjtë dhe minjtë gjirizesh të mbahen përherë vetëm në grupe.

Ku të blihen? Çka të merret parasysh?

Brejtësit e vegjël mund të blihen në një shtëpi për kujdesen e kafshëve të braktisura të një organizate për mbrojtjen e kafshëve ose te një stacion mbledhës (klubi i adhuruesve të minjve gjirizesh „Club der Rattenfreunde"), ose atëherë në dyqanet e specializuara të kopshtit zoologjik, të cilat mbajnë vinjetën e Mbrojtjes Zvicerane të Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS) dhe këshillojnë klientët në mënyrë kompetente. Kafshët duhet të kenë gëzofë të lëmuar dhe shkëlqyes, sy të shndritshëm dhe të mos kenë rrjedhje nga hunda.

Çka ju nevojitet minjve gjirizesh?

Minjtë gjirizesh duhet të mbahen ose në një kafaz të madh, në një kafaz të madh zogjsh të kthyer në formë të re, në një dollap të ndryshuar ose në kafaze speciale për minjë gjirizesh (për shembull vila për kafshët e vogla të preferuara nga Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), të cilat duhet të kenë të gjitha së paku 1 m² sipërfaqe shfrytëzuese. Pajisja duhet t´ju jep mundësin minjve gjirizesh, që ta shfrytëzojnë kafazin në të gjitha (tre) dimensionet. Orendi të përshtatshme janë dërrasat në kate, degët për ngjitje, kthinat për fjetje, gypat, konopë, hamok (shtrat i varur), tunele, ura të varura, shkallë...Fundi mbulohet trash me tallash (ashkla) të lirë nga pluhuri, meqë edhe minjtë gërmojnë me gjithë qejf. Natyrisht që edhe te minjtë mund të shfaqen alergjitë - atëherë përdoreni më mirë shami/lecka që mund të lahen. Minjtë gjirizesh kanë nevojë rregullisht për degë të freskëta si material brejtës. Jo helmuese janë: bredhi i kuq, bredhi i bardh, lajthia, shelgu, ahu, mështekna, bliri, pemët frutore të pa stërpikura. Minjtë gjirizesh hanë pemë dhe perime, herë pas here arra, misër dhe përzierje drithërash, nganjëherë bukë të fortë me miell të pasitur (bukë e zezë). Mos ju jepni ushqim macesh ose mish. Minjtë gjirizesh duhet të kenë mundësi ta shijojnë çdo ditë vrapimin e lirë, mundësisht në mbrëmje në të njëjtën kohë (kujdes te kabllot!).

Çka ju nevojitet vidhezave (hamsterëve)?

Vidhezat e arta janë si ngjitëse të mira ashtu edhe gërmues të mirë. Terrenet (100 deri 150 cm të gjatë, së paku 50 cm të lartë dhe të gjerë) duhet të kenë së paku 30 cm mbulesë (mbushje) me një përzierje prej tallashit (ashes), sanës, kashtës dhe shumë degëve të ngritura si mundësi për ngjitje. Por të përshtatshëm janë edhe kafazet e mëdha shumëkatëshe, stabile, me një kupë të thellë (për shembull vilat për kafshë të vogla të preferuara nga Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), kati i fundit i të cilëve mund të shndërrohet në një kupolë varri. Enët për të pirë duhet të vendosen në rrjetë ose në mure dhe duhet të jenë gjithmonë të arritshme – edhe këto kafshë shkretëtire kanë nevojë për ujë! Tagjia (drithi) mund të hidhet mbi mbulesën e shtruar, veçse nuk bën të ketë shumë fara luledielli, ngase kafshët trashen shumë. Vidhezat çmojnë veç kësaj edhe kosin, nganjëherë mishin e grirë pa dhjamë, frutat e freskëta, sallatat dhe perimet, si dhe herë pas here një copë bukë të fortë me miell të pasitur. Meqë vidhezat mbledhin ushqim, duhet të largohet gjithnjë ushqimi i njomë, me qëllim që mos fillon të myket në magazinën e kafshës. Vidhezat kanë nevojë rregullisht për degë të njoma dhe gypa prej kartonit si material brejtës. Vidhezat duhet të kenë mundësi gjerësisht të gërmojnë dhe të ngjiten dhe me siguri nuk kanë nevojë për rrotë.

Çka ju nevojitet minjve vrapues?

Minjtë vrapues janë ngjitës të këqij, por gërmues të mirë. Terrenet për minj vrapues (100 deri 150 cm të gjatë, së paku 50 cm të lartë dhe të gjerë) duhet të kenë së paku 30 cm mbulesë (mbushje) me një përzierje prej tallashit, sanës, kashtës dhe degëve. Enët për të pirë duhet të vendosen në kapakun e rrjetës ose në mure dhe duhet të jenë gjithmonë të arritshme – edhe këto kafshë gjysmëshkretëtire kanë nevojë për ujë! Tagjia (drithi) mund të hidhet mbi mbulesën e shtruar, veçse nuk bën të ketë shumë fara luledielli dhe kungulli, se trashen kafshët shumë dhe kjo i bëhen të

ndjeshëm ndaj sulmit në tru. Minjtë vrapues çmojnë veç kësaj edhe kosin, frutat e freskëta dhe perimet. Minjtë vrapues kanë nevojë rregullisht për degë të njoma, bukë të fortë, kashtë dhe gypa prej kartonit si material brejtës. Minjtë vrapues nuk janë kafshë përkëdhelëse, ato mund ti kap bile gjatë nxjerrjes jashtë edhe sulmi epileptik.

Tredhja / grupet e gjinisë së njëjtë

Duhet hequr dorë nga shtimi i kafshëve, ngaqë vendosja e kafshëve të reja në vendet vërtet të volitshme për jetën e kafshëve është jashtëzakonisht e vështirë, shpesh madje e pamundshme dhe shumë prej këtyre kafshëve presin për një vend të mirë në shtëpitë për kujdesjen e kafshëve të braktisura dhe stacionet mbledhëse. Më së miri mbahen grupet e seksit të njëjtë, fakt që është provuar te minjtë vrapues me të dy gjinitë dhe te femra e minjve gjirizesh si s´ka më mirë. Meshkujt e minjve gjirizesh duhet të tridhen, pastaj mund të jetojnë edhe ata rehat në grupe. Vidhezat e artë janë të vetmuara, d. m. th. ata jetojnë vetëm, ndërsa llojet e caktuara të vidhezave shkurtabiq mund të mbahen edhe në grupe të vogla.

Kafshët dhe pushimet

Brejtësit e vegjël të ndjeshëm ndaj stresit rrinë më së miri në kafazet e tyre tek shtëpia, ushqehen dhe mirëmbahen prej një personi të specializuar dhe të besueshëm. Ata mund të strehohen si alternativë në një pansion për kafshë ose në një shtëpi për kujdesjen e kafshëve të braktisur, gjë që kushton 10-20 franga në ditë. Lëshimi i kafshëve në rrugë është e ndaluar me ligj dhe mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 20 000 franga.

Minjtë gjirizesh, minjtë vrapues, vidhezat dhe fëmijët

Brejtësit e vegjël të mbajtura sipas llojit përkatës ofrojnë mundësi tepër tërheqëse vrojtimi për fëmijë. Një i rritur duhet ta merr përgjegjësinë, ti udhëzon dhe mbikëqyr fëmijët në sjelljen e tyre ndaj me kafshëve. Megjithatë këto lloje të kafshëve nuk janë kafshë ledhatuese për tu mbartur me vete. Është vërtetur që kafshët e vogla brejtëse vuajnë jashtëzakonisht nga stresi – rrahje të zemrës dhe dobësim i imunitetit trupor –, nëse nxirren jashtë dhe përkëdhelen dhe ju nevojiten së paku 2 orë për tu çlodhur prapë. Por ama ata e çmojnë vrapimin e lirë të rregullt, kur të kenë mundësi vetë të zbresin jashtë dhe prapë të ngjiten brenda. Vidhezat dhe minjtë gjirizesh si kafshë aktive të natës janë më pak të përshtatshëm për fëmijë se sa minjtë vrapues, të cilët janë aktiv të ditës.

Informacionet dhe vendet për kontakt

- „Ratten“ (minjtë gjirizesh), „Rennmäuse“ (minjtë vrapues), „Hamster“ (vidhezat/hamsterët), „Mäuse“ (minjtë), „Degus“, „Chinchillas“, „Prospekt artgerechte Gehege“ (prospekte kafaze sipas llojit) (gjermanisht, frëngjisht, italisht), fletë udhëzuese e Mbrojtjes Zvicerane të Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), mund të porositen falas kundër një zarf C5 të pajisur me pullë dhe të adresuar vetvetes. Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, Postfach, 4008 Basel, këshillim për brejtësit e vegjël (gjermanisht, frëngjisht, anglisht) dhe porositje e materialit Tel. 061 365 99 99, Faksi: 061 365 99 90, sts@tierschutz.com, www.tierschutz.com
- Club der Rattenfreunde (Klubi i miqve të minjve gjirizesh), Sektion des Schweizer Tierschutz STS (seksion i Mbrojtjes Zvicerane të Kafshëve STS), www.rattenclub.ch, info@rattenclub.ch, telefoni këshillues: 078 670 33 31, ndërmjetësimi i minjve gjirizesh 079 624 23 20

Redaktor:
Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, 4008 Basel,
Tel. 061 365 99 99, Fax 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com